Per gjithë periudhen e audituar rezulton se te ardhurat jane te rakorduara me degen e Thesarit periodikisht dhe ne fund te vitit, jane percaktuar drejt tarifat per sherbimet gjyqesore ne perputhje nenit 11 te ligjit nr.9975 date 28.07.2008 " Per taksat Kombetare", me udhezimin nr.13 date 12.02.2009 "Per percaktimin e tarifes se sherbimit per veprime e sherbime te administrates gjyqesore e M.Drejtësisë ,sherbimit permbarimor shtetëror,prokurorise" si dhe udhezimit Nr 991/3 date 02.03.2010 "Per nje ndryshim ne udhezimin nr.13 date 12.02.2009 " Per percaktimin e tarifes se sherbimit ...administrates gjyqesore .

Nga audimi i kryer per perdorimin e te ardhurave rezultoi se jane perdorur ne perputhje me udhezimin e perbashket nr.01 date 08.03.2013 "Per perdorimin e te ardhurave te krijuara nga tarifat e sherbimeve te administrates gjyqesore" te M.Financave dhe Kryetarit te Bordit te ZABGJ dhe jane perfshire ne buxhetin e gjykates ne perudhat perkatese.

4.4.Sistemi i transaksioneve për blerjet, shpenzimet dhe rregjistrimi i tyre në rregjistrat e kontabilitetit

U auditua me zgjedhje dokumentacioni i bankës përkatësisht : për vitin 2013(nga 01/09) 54 %, për vitin 2014 41 % dhe për vitin 2015 (deri 31/08/2015 30 % .

Në përfundim të auditimit rezulton se regjistrimet ne ditarin bankes janë bërë korrekt si për vlerat ashtu edhe për kronologjinë e regjistrimit të ngjarjeve ekonomike .

Janë kryer rakordimet periodike dhe vjetore me Degën Thesarit, për situacionet e shpenzimeve mujore dhe vjetore të raportuara nga dega e buxhetit .

Rakorimet janë të konfirmuara nga dega e Thesarit dhe janë pjesë shoqëruese e dokumentacionit të bankës.

Nga krahasimi i te dhenave te thesarit me të dhënat e ditarit të bankës konstatohet se vlerat janë korrekte të sakta dhe të pasqyruara drejt.

Dokumentacioni shoqërues i cdo transaksioni është i konfirmuar me vulën e thesarit

Pagat e punonjësve janë kaluar në llogaritë personale në bankë dhe nga ana e tyre nuk ka reklamime.

Njëkohësisht u bë krahasimi i cmimeve në kontratat e lidhura ,në blerjet me vlera të vogla me faturat e lëshuara nga operatorët ekonomikë si dhe fletëhyrjeve të magazinës dhe rezulton se janë të barabarta.

**RAPORT FINAL-
GJYKATA E APELIT VLORE**

U auditua dokumentacioni shoqërues i Urdhër Shpenzimeve , si faturat , kontratat , flet hyrjet e magazinës , përmbledhëset e listpagesave dhe listpagesat,etj dhe rezultoi se vlerat e tyre përputhen me vlerat në urdhër shpenzim.

Shpenzimet për avokatë të thirrur kryesisht , ekspertë, përkthyes , psikologe

Gjatë ushtrimit të misionit të auditimit të shpenzimeve dhe pagesave konstatohet se në kampionin e perzgjedhur pagesa e avokatëve të thirrur kryesisht, është kryer duke respektuar si limit tavan tarifat e përcaktuara në Urdhërin Nr. 1284/3 datë 16.3.2005 të Ministrisë Drejtësisë dhe Kryetarit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe mbi bazën e faturës me tvsh në përputhje me VKM nr 1058 datë 21.10.2009 "Për përcaktimin e kufirit minimal të regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar"(i ndryshuar). Bashkëlidhur U.Shpenzimeve janë faturat tatimore me TVSh, vendimet e ndermjetem te gjyqtarit apo vertetimet për nr. e vendimit gjykatës dhe masa e shpërblimit.Ne te gjithë kampionin e perzgjedhur konstatohet se masa e pageses se avokateve te thirrur kryesisht eshte nen nivelin e përcaktuar ne urdherin e mesiperm.Konstatohet se ne nje rast me U.SH. nr 259 date 24/12/2014 pagesa e avokatit eshte kryer njeheresh per gjithë vitin ne kundërshtim me udhëzimin e bordit nr.1 date 11.07.2014 .

Ekspertët janë paguar në përputhje me udhëzimin e K.M nr. 4 datë 12.12.2012" Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor", akte ekspertimi keto te kryera nga IML.

Pagesa e përkthyesve ne dy raste (U.SH. nr. 218 date 02/12/2013 dhe U.SH. nr. 229 date 10/12/2013) nuk është kryer ne perpuhje me udhëzimin nr 3165 date 12.05.2004.Ne te dy rastet mungon dokumentacioni vertetues (nr.i fageve te perkthyer, koha e perkthimitnë seanca).Njekohesisht me USH nr 229 date 10/12/2013 perkthyeses znj.Valbona Gerlica i jane paguar shpenzime per karburant ne masen 5769 lek pa asnje dokumentacion vertetues dhe shpenzime perkthimi ne seance per nje ore ne shumen 3 500 lek nderkohe qe nga verifikimi ne sistem dhe ne proceverbalin e seances rezultoi se seanca ka zgjatur 10 minuta nga ora 9:58 deri ne oren 10:08 dhe pagesa perkatese duhet te ishte 600 lek. Keto pagesa jane kryer me vendim te ndermjetem te gjykates.Pagesa me teper per perkthyesen znj. Valbona Gerlica ne masen 8 669 lek perben dem ekonomik .

Nga dega e buxhetit është kryer ndalesa e tatimit ne burim për pagesat e kryera dhe është derdhur ne Degen e Tatim Taksave Vlorë.

Auditi rekomandon :

- 1. Për llogaritjen e pagesave për shërbimet e eksperteve, përkthyesve , avokateve, psikologeve etj, ne rastin kur për pagesen e tyre veprohet me vendim te ndermjetem gjyqësor, përpara shpalljes se vendimit te ndermjetem duhet te dorezohet dokumentacioni vertetues , justifikues ,etj ,i punes se kryer nga ta , te llogariten shpenzimet nga dega e buxhetit dhe kancelaria te nënshkruhen prej tyre dhe te paraqiten prane gjyqtarit nepermjet sekretares se seances .Ndersa ne rast se perdoret vertetimi ky duhet te konfirmohet nga kancelari duke i bashkelidhur dokumentacionin vertetues ne rastet kur ka shpenzime te tjera ne perputhje me legjislacionin ne fuqi .***
- 2. Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", pjesa VI, kreu I, nenet 105-109, të nxirret akti administrativ, të kryhet kontabilizimi dhe të bëhet ndalesa për pagesat e kryera me teper për përkthyesin ne vleren 8669 lek .***

Shpenzimet per udhetime e dieta.

RAPORT FINAL
GJYKATA E APELIT VLORE

Në auditimin e shpenzimeve për udhetime e dieta në kampionin e perzgjedhur shtator, dhjetor 2013, korrik, tetor, dhjetor 2014 dhe mars, korrik 2015 gjithsej 24 U. Shpenzime konstatohet se në të gjitha këto urdher shpenzime nuk është zbatuar i plotë VKM nr 997 datë 10/12/2010 pika V, citoj: (V. Dërgimi me shërbim i punonjësit autorizohet nga:

Titullari i institucionit qendror për shërbime në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës. Në autorizim përcaktohen koha e zgjatjes së shërbimit dhe qëllimi i tij) dhe konkretisht :

• Mungon autorizimi i dërgimit me shërbim .

• Qëllimi i dërgimit me shërbim dhe kohëzgjatja e tij.

3. **Auditi rekomandon:** *Per punonjesit qe dergohen me shërbim jashte qendrës së punës dhe perfitojne dietë ne përputhje me VKM 997 date 10/12/2010 Kryetari gjykates duhet te autorizojë dërgimin me shërbim te punonjesit ku te përcaktohet qëllimi dhe koha e zgjatjes së shërbimit.*

Shpenzimet për energji elektrike ,ujë ,telefon ,shërbim postar etj.

Nga auditimi i shpenzimeve për energji elektrike dhe ujë, konstatohet se ato janë kryer mbi bazën e faturave mujore të lëshuara nga ana e operatorëve të energjisë elektrike dhe ujit. Faturimi i energjisë elektrike kryhet i përbashket me Prokurorinë e Apelit. Midis dy institucioneve nuk ka marrveshje të shkruar për masën e pagesës së secilit . Në këto kushte egziston mundësia e krijimit të ndonjë kredie të mundshme ndaj këtij operatori .

Faturimi i ujit nga operatori ekonomik kryhet pa matje në mënyrë afrofe për gjithë periudhën e audituar kjo për arsye se në gjykatë nuk është instaluar matesi i konsumit të ujit.

Nga auditimi i shpenzimeve për telefon celular rezulton se është respektuar limiti përcaktuar me VKM nr 864 datë 23/07/2010 pika 14 dhe 15 i ndryshuar . Faturat nga ana e telefonisë celulare vijnë në vlera më të larta se tarifa e përcaktuar dhe diferenca paguhet nga punonjësit që zoterojnë këta numra por nga dega e buxhetit nuk ka dokumentacion të pagesës së kësaj difference dhe nuk ka rakordim me operatorin e telefonisë celulare.

Auditi rekomandon :

1. *Per enegjiine elektrike konsumi i se ciles kryhet nga nje mates te lidhet akt marrveshje me Prokurorine e Apelit Vlore ku te përcaktohet masa e pagesës në përputhje të secilit institucion dhe të administrohet në arkivën e gjykatës.*
2. *Nga ana e krytarit të merren masa për ndërprejen e faturimit afrofe të konsumit të ujit duke i kerkuart zyrtarisht ndërmarrjes së ujsjellesit instalimin e matesit të konsumit të ujit.*
3. *Nga dega e buxhetit të kryhet rakordimi vjetor me operatorët e ekonomike me akt rakordimi me shkrim ,te neneshkruar nga palet dhe të administrohen në dokumentacionik ekonomik financiar të gjykatës.*

Auditimi i veprimeve të Arkës dhe i letrave me vlerë

Mjetet monetare dhe vlerat tjera pranë arkës (pullat e takses) ruhen në kasafortën që ndodhet pranë arkës .

U auditua dokumentacioni i arkës dhe i letrave me vlerë për vitin 2013 (nga 01/09) ,vitin 2014 dhe 2015 (deri 31/08).

Nga auditimi konstatohet se nga ana e degës buxhetit është mbajtur ditari i arkës dhe ditari i pullave të takses ,ndërsa nga ana e arkëtares është mbajtur libri arkës dhe libri i pullave të takses.

RAPORT FINAL
GJYKATA E APELIT VLORE

Në ditarin e arkës dhe në librin e arkës janë pasqyruar arketimet nga fotokopje dhe arketime per eksperte si dhe pagesat per eksperte dhe derdhjet ne banke nga fotokopjet . Ndersa ne ditarin dhe librin e pullave jane pasqyruar terheqjet nga dega e tatim taksave te vleres se pullave dhe derdhjet ne banke te vleres se pullave te shitura.

Nga auditimi i veprimeve te arkës dhe letrave me vlere konstatohet se:

1. Ne ditarin e arkës nuk pasqyrohet gjendja e arkës ne mbyllje te vitit ushtrimor per vitin 2014 dhe ne celje te vitit ushtrimor 2015 ne vleren 95 000 lek ne kundershtim me ligjin "Per kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" si dhe ne kundershtim me udhezimin nr 30 datë 27/02/2011 "Për menaxhimin e Aktiveve në NJSP" pika 23.c " *Depozitimi ne llogarite e sistemit te thesarit i vlerave monetare të arkëtuara nga te gjitha nivelet e njësise se qeverisjes se pergjithshme, menjehere pas pranimit te tyre*". Kjo shume eshte e pasqyruar vetem ne librin e arkës.

2. Arketimet nga shitja e pullave nuk pasqyrohen as ne ditarin e arkës dhe as ne librin e arkës dhe njekohesisht nuk regjistrohen edhe mandat pagesat per derdhjet ne banke ne kundershtim me udhezimin nr 30 datë 27/02/2011 "Për menaxhimin e Aktiveve në NJSP" pika 62 . " *Veprim arke është shërbimi i arkëtimit dhe i pagesës me para në dorë që bëhet në te gjitha nivelet e njesise publike, në bazë të mandatarkëtimit ose të mandatpagesës*".

3. Ne arke konstatohen arketime ne vlere me te larta se 1000 lek ne kundershtim me udhezimin nr 30 datë 27/02/2011 "Për menaxhimin e Aktiveve në NJSP" pika 64 " *Veprimet me para ne dore kryhen per transaksionet financiare ne formen e paradhenies per udhetime e dieta, gjithashtu edhe per arketimin e te ardhurave ne vlere me te vogla se 1000 leke*". Keto vlere arketohen dhe kryhen pagesa kryesisht per eksperte per ceshtje civile per te cilen gjykata nuk ka asnje detyrim por eshte detyrim i paleve me ekspertet . (MA nr.2 date 15/04/2014 me vlere 30000 lek, MA nr 3 date 22/04/2014 me vlere 20000 lek, MA nr 5 date 18/07/2014 me vlere 24000 lek dhe MA nr 2 date 01/06/2015 me vlere 30000 lek).

4. Veprimet e shitjes se pullave kryhen nga kancelarja dhe dorezohen tek arketarja pas mbarimit te nje tabaku prej 36 000 lek dhe jo ne fund te cdo dite pune.

Per sa me siper audit i shpreh opinionin se veprimet me arken dhe letrat me vlere kryhen formalisht per pjesen e ditarit te arkës dhe ne ndjekjen e veprimeve te arkës dega e buxhetit bazohet ne librin e arkës qe mban arketarja .

Mosmbajtja e ditarit te arkës ne perputhje me ligjin "Per kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe arketimi e mbajtja e vlerave monetare ne shuma te larta bie ne kundërshtim me udhezimin nr 30 datë 27/02/2011 "Për menaxhimin e Aktiveve në NJSP" pika 23.c ,62,64,67, ku është përcaktuar se :

Pika 23.c Depozitimi ne llogarite e sistemit te thesarit i vlerave monetare të arkëtuara nga te gjitha nivelet e njësise se qeverisjes se pergjithshme, menjehere pas pranimit te tyre.

Pika 62 . "Veprim arke është shërbimi i arkëtimit dhe i pagesës me para në dorë që bëhet në te gjitha nivelet e njesise publike, në bazë të mandatarkëtimit ose të mandatpagesës".

Pika 64. "Veprimet me para ne dore kryhen per transaksionet financiare ne formen e paradhenies per udhetime e dieta, gjithashtu edhe per arketimin e te ardhurave ne vlere me te vogla se 1000 leke"

Pika 67. Për veprimet e arkës mbahen llogari kontabile të arkës nga sektori i financës dhe libër arke nga punonjësi i caktuar me përgjegjësinë e lëvizjes së vlerave monetare.

Nga grupi i auditimit u krye inventarizimi fizik i arkës duke u bazuar në akt rakordimin e mbajtur midis gjykatës dhe degës së tatim taksave për gjendjen e pullave të taksës më 31/12/2014 sipas akt konstatimit nr.01 datë 19/11/2015 .Nga kryerja e inventarit nuk rezultuan diferenca në mjete monetare dhe letra me vlerë .

Auditi rekomandon :

1. Nga dega e buxhetit te merren masa për mbajtjen e ditarit te arkës , librit te arkës ,librit te pullave ne përputhje me ligjin “Per kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” , kryerjen e veprimeve te arkës ne përputhje me udhezimin nr 30 datë 27/02/2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në NJSP” si dhe depozitimimin ne llogarite e thesarit te vlerave monetare të arkëtuara menjehere pas pranimi te tyre.

2. Vlera prej 95 000 lek gjendje ne arke qysh nga viti 2013 te depozitohet menjehere ne llogarite e thesarit si e ardhur per llogari te buxhetit te shtetit

3. Nga ana kryetarit gjykates te merren masa per ndalimin e arketimeve ne arken e gjykates te shumave per llogari te eksperteve ne çeshtje civile por depozitimi i tyre ne banke ne llogarite e eksperteve.

Auditimi i veprimeve të magazinës

U audituan me zgjedhje veprimet e magazines perkatesisht : per vitin 2013 50% e dokumentacionit, për vitin 2014 59% e dokumentacionit dhe për vitin 2015 55% e dokumentacionit .

Nga auditimi rezultoi se, dokumentacioni i hyrjeve dhe daljeve të materialeve dhe mallrave në magazinë është plotësuar , në përputhje me legjislacionin në fuqi. Nga dega e buxhetit, regjistrimet e veprimeve të magazinës, në ditar, janë kryer në mënyrë kronologjike .

F.Hyrjet dhe F.Daljet janë prerë mbi bazën e dokumenteve justifikues ,fatura blerje me ose pa tvsh për hyrjet e magazinës dhe urdhër dorëzimit ose plan shpërndarjes të autorizuar nga kancelarja, për daljet e magazinës një kopje e të cilave sëbashku me dokumentacionin shoqërues është dërguar në degën e buxhetit për kryerjen e veprimeve të mëtejshme. F.Hyrjet dhe F.Daljet janë të firmosura nga magazinjeri dhe financieri. Nga ana e magazinës është mbajtur libri i magazinës në kartela të vecanta ku janë pasqyruar të gjitha lëvizjet dhe gjendjet e artikujve Ndërmjet kartelave të magazinës dhe llogarisë është kryer rakordimi në sasi e në vlerë çdo muaj. Pajisjet dhe materialet e inventarit u janë dhënë punonjësve me kartela personale të nënshkruara prej tyre.

Gjykata e Apelit Gjyqësor Vlore ka në përdorim dy autovetura, nje tipit” Hunday” dhe një e tipit “W.Bora” përdorur më parë dhe një motociklete te cilat janë në gjendje pune.

Nga auditimi i ushtruar për shërbimet e mirëmbajtjes së automjeteve rezulton se ato janë kryer me procedure prokurimi “Blerje me vlerë të vogël”. Për autoveturat është mbajtur kartelë për km. e përshkuara për riparimet e kryera dhe pjesët e këmbimit te vendosura gjatë riparimit.

Nga shqyrtimi dokumentacionit rezulton se konsumi i karburantit është bërë mbi bazën e km. të përshkuara, normativës së konsumit të përcaktuar me matje faktike të kryera me komision të ngitur mbi bazën urdhërit të brendshëm të kryetarit.

Për konsumin e karburantit janë mbajtur fletë e udhëtimet mujore të cilat jane firmosur nga shoferi për destinacionin e nisjes e të mbrritjes dhe punonjësi të cilit i është vënë autovetura në dispozicion. Në fletë udhëtime është pasqyruar data dhe sasia e furnizimit me karburant.

Inventarizimi i pasurisë publike

Eshtë kryer inventari fizik i gjendjes së Aktiveve Afatshkurtëra dhe Aktiveve Afatgjata të trupëzuara, në magazinë dhe në përdorim nga komisioni i inventarizimit i ngritur me urdhër të kryetarit të gjykatës nr 161 datë 13/12/2013 dhe per vitin 2014 me urdherin e brendshem nr 80 date 27/11/2014.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të inventarizimeve rezolton se është respektuar procedura sipas udhëzimit nr 30 datë 27/02/2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në NJSP”.

**RAPORT FINAL
GJYKATA E APELIT VLORE**

Nga grupi i auditimit u krye inventar fizik me zgjedhje për një grup artikujsh sipas Akt konstatimit nr. 19/11/2015. Nga krahasimi i gjendjes fizike dhe gjendjes kontable nuk rezultuan diferenca. Kushtet e mbajtjes së materialeve në magazinë janë optimale .

Për vitin 2013 janë nxjerre jashtë përdorimit aktiv eafatgjate me vlere 500 967 lek dhe per vitin 2014 janë nxjerrë jashtë përdorimit aktive afatgjatë në vlerën 776875 lek .

Nga auditimi i dokumentacionit për nxjerrjen jashtë përdorimit rezulton se per vitin 2013 per vleren e aktiveve afatgjate ne zerin Paisje Elektronike ne vleren 387 811 lek nuk eshte marre miratimi nga Drejtori i ZABGJ ne kundershtrim me udhezimin nr 30 datë 27/02/2011 "Për menaxhimin e Aktiveve në NJSP" pika 112 a.ndersa per pjesen tjeter dhe per vitin 2014 procedura e ndjekur është në përputhje me ligjin 10296 datë 8/7/2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" dhe udhëzimit nr. 30 datë 27/02/2011 "Menaxhimi i Aktiveve në NJSP".

Nga ana e nëpunësit zbatues është hartuar regjistri analitik i aktiveve në përputhje me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Menaxhimi i Aktiveve në NJSP". Gjendja e aktiveve ne bilanc rakordon me gjendjen e aktiveve me 31/12/2014.

4.5 Organizimi, mbajtja e kontabilitetit dhe Pasqyrat Financiare

Misioni i auditimit u ushtrua edhe në mbajtjen e kontabilitetit dhe të pasqyrave financiare për periudhen 01/01/2013 deri 31/12/2014 .

U audituan transaksionet financiare të arkës në lekë dhe valutë, të veprimeve me bankën, veprimeve me magazinën. Kontabilizimi i pagave, shpenzimeve ,blerjeve,lëvizjeve të magazinës,të aktiveve bëhej në ditar të rregullt të cilët jepnin në fund të çdo periudhe gjendjen e llogarive dhe shërbenin për nxjerrjen e llogarive në fund të vitit buxhetor, pra të bilancin kontabël.

Veprimet kontabël në këtë institucion janë mbajtur duke i rregjistruar në ditare dhe janë përdorur drejt artikujt kontabël në ditarët : " Banka", ditarët e "Hyrjeve dhe Daljeve të magazinës", ditarin e "Veprimeve të Ndryshme", por jo ne ditarët e "Shpenzimeve","Ditari i Arkës" ,"Ditari i të Ardhurave".

Pasqyrat Financiare

Nga auditimi i realizuar konstatohet se hartimi i pasqyrave financiare kryhej sipas përcaktimeve të ligjit Nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" nenet 3 dhe 5 të tij. Gjithashtu janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore .

Pasqyrat Financiare në analizë, kanë inventarin kontabël të cdo llogarie sipas V.K.M Nr.248, datë 10.4.1998 "Për planin kontabël të institucioneve buxhetore" dhe Udhëzimeve përkatëse të Ministrisë Financave "Per mbylljen e vitit financiar dhe paraqitjen e raportit vjetor".

Pasqyrat Financiare shoqërohen me raportin vjetor të bilancit dhe anekset përkatës. Për vitin 2013 dhe 2014 bilanci është përpiluar dhe është dorëzuar në degën e Thesarit Vlore , në Ministrinë e Drejtësisë ,Drejtorinë ekonomike dhe pranë Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor sipas afateve të përcaktuara ligjore.

Bilanci pasqyron saktë e me objektivitet shpenzimet, të ardhurat, aktivet dhe pasivet. Nga auditimi i të dhënave të llogarive në celje te vitit ushtrimor rezulton se vlera e tyre përputhet me gjendjen në mbyllje të vitit paraardhës Po kështu gjendja e llogarive në Bilanc përputhet me gjendjen e llogarive në fund të vitit në ditarët përkatës.

Në aktiv janë paraqitur të gjitha aktivet e qëndrueshme. Amortizimi është llogaritur sipas normave të amortizimit mbështetur në Udhëzimin nr.26 datë 27.12.2007 "Për përgatitjen e raportimin e pasqyrave Financiare Vjetore për Institucionet Qëndrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe njesive që varen prej

**RAPORT FINAL
GJYKATA E APELIT VLORE**

tyre. Kërkesat për debitor, pasqyrojnë detyrimin e buxhetit për pagat dhe shtesat e tjera , që paguhen në janar të vitit pasardhës.

Llogaritë vjetore të viteve 2013 dhe 2014 për Gjykatën e Apelit Vlorë janë paraqitur sipas formatit të miratuar nga Ministria e Financave dhe në zbatim të V.K.M. nr.248 date 10.04.1998 “Për Miratimin e Planit Kontabël Publik të Organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qëndrore e Lokale si dhe Njësive që varen prej tyre, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.26 datë 27.12.2007 “Për përgatitjen e raportimin e pasqyrave Financiare Vjetore për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/ zbatimit të Projekteve e Marrëveshjeve me Donatorë të Huaj – dhe formateve të Pasqyrave Financiare të miratuara “

Të dhënat në këto pasqyra janë të sakta dhe korrekte”

4.6. Sistemi i prokurimeve me vlera të larta dhe vlera të ulëta

Është hartuar dhe miratuar regjistri i parashikimeve dhe realizimeve të prokurimeve publike për vitin 2014 dhe 2015. Në rastet e ndryshimeve, është bërë kërkesa e argumentuar për ndryshimin dhe pas miratimit janë kryer veprimet e ndryshimit në regjistër. Rregjistri i prokurimeve publike për të dy vitet është dërguar në APP në afatet e përcaktuara ligjore.

Prokurimet me vlera të Larta

Per periudhen nën auditim janë kryer gjashtë prokurime me vlerat e larta nga të cilat tre në vitin 2014 dhe tre në vitin 2015.

Prokurimet janë kryer nëpërmjet sistemit elektronik . Auditimi i prokurimeve u krye nëpërmjet sistemit elektronik dhe këqyrjes së dosjeve fizike .

Nga auditimi u konstatua se :

- Perlllogaritja dhe argumentimi I fondit limit (vlera limit e kontrates) për tenderin e blerjes karburantit për vitin 2014 është formale pasi nuk është përcaktuar sasia e karburantit
- Nuk është kryer perlllogaritja e vlerës limit të kontrates për tenderin e “Ruajtjes dhe sigurisë fizike të gjykates “ dhe “Blerje paisje elektronike “ të kryera gjatë vitit 2015.

Për tenderin “Rikostruksion i Sallave dhe Hidroizolim i Tarracës Gjykates” të kryer në vitin 2015 nuk u auditua pjesa e zbatimit të punimeve pasi përfundimi i punimeve është shtyre mbi afatin e parashikuar në kontratë dhe është në zbatim e sipër.

Dosjet e prokurimeve janë të inventarizuara dhe të arshivuara me përjashtim të dosjes së rikostruksionit dhe hidroizolimit punimet për të cilin janë në proces.

Auditi rekomandon:

1. *Njesia e Prokurimit perpara hartimit te Urdherit te Prokurimit duhet te kryeje llogaritjen e Vleres Limit te Kontrates(fondit limit) dhe ta administroje ate ne dosjen e prokurimit ne perputhje me VKM nr.914 date 29.12.2014.”Rregullat e Prokurimit Publik” neni 9, neni 57,59.*
2. *Kryetari Gjykates ne cilesine e autoritetit kontraktor te marri masa per trajnimin e punonjesve te angazhuar ne prokurimet publike ne zbatim te VKM nr.914 date 29.12.2014.”Rregullat e Prokurimit Publik” neni 83 ,pika 2 .*
3. *Kryetari Gjykatës në cilesine e autoritetit kontraktor të marrë masa për mbikqyrjen e cilësive të realizimit të kontratave veçanërisht të ruajtjes dhe sigurisë fizikese godinës gjykatës në përputhje me VKM nr.914 date 29.12.2014.”Rregullat e Prokurimit Publik” neni 77.*

**RAPORT FINAL
GJYKATA E APELIT VLORE**

Nga analiza e prokurimeve me vlera te larta per periudhen nen auditim rezulton se i jane kursyer shpenzimet te shtetit nje vlere prej 2 080 060 lek te cilen gjykata e ka perdorur per mbulim te shpenzimeve te tjera. Situata paraqitet ne tabelen si vijon

Nr	Pershkrimi	Fondi Limit	Vlera e Prokuruar	Diferenca
1	Blerje Tonera	804.000	688.459	115.541
2	Blerje Karburanti	750.000	750.000	-
3	Ruajtje dhe Siguri Fizike	1.080.000	1.020.000	60.000
	Viti 2014	2.634.000	2.458.459	175.541
1	Ruajtje dhe Siguri Fizike	1.336.800	1.335.600	1.200
2	Blerje Paisje Elektronike	2.790.000	2.752.084	37.916
3	Rikostroksion Sallash dhe Hidroizolim Tarace	4.227.238	2.361.835	1.865.403
	Viti 2015	8.354.038	6.449.519	1.904.519
	Totali :	10.988.038	8.907.978	2.080.060

Prokurimet me vlera të ulëta

Gjatë procesit të auditimit të blerjeve me vlera të vogla rezulton se kjo procedurë është përdorur në 18 raste për vitin 2013 (Shtator – Dhjetor) dhe në 30 raste për vitin 2014 dhe 16 raste për vitin 2015 (Janar – Gusht). Blerjet me vlera të vogla janë kryer mbi bazën e urdhërave të brendshëm kryetarit nr. 03 datë 06/01/2013, nr 01 datë 06/01/2014 dhe nr 02 date 05/01/2015 “Për ngritjen e komisionit për blerjet me vlera të vogla” dhe komisioneve të marrjes në dorezim nr 3 date 06/01/2014 dhe nr.01 date 15/01/2015.

Procedurat për blerjet me vlera të vogla janë realizuar nëpërmjet sistemit elektronik.

Nga shqyrtimi dokumentacionit dhe futjes në sistemin elektronik të blerjeve me vlera të vogla rezulton se nuk është zbatuar e plote gjurma e auditit sipas udhëzimit të Min.Fin. Nr.92, datë 29.12.2011, i ndryshuar me urdhërin nr 33 datë 12/06/2014 “Për gjurmën standarte të auditit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë” dhe Urdhërit Nr. 1. datë 15.02.2013. të Bordit Zyrës “Për gjurmët standarte të auditit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë në njësitë shpenzuese të gjyqësorit”.

Moszbatimi konstatohet në mungesën e llogaritjes dhe argumentimit të fondit limit.

Në dy raste për riparimin e motocikletës është përdorur procedura emergjente ndërkohë që është e pajustifikuar (USH nr 230 dt.1712/2013 dhe USH nr 233 date 03/12/2014).

V.Sistemi Informatik

Në institucionin e Gjykatës së Apelit Vlore ka 24 përdorues kompjuteri në përdorim janë 34. Gjendja e sistemit është e mirë. Ka disa paisje të cilat janë identifikuar nga institucioni që janë jo funksionale dhe që janë në përfundim të amortizimit kontabel të cilat do të zvendeshen në vijimësi.

Zbatimi i detyrave të lëna nga auditimet e mëparshme.

Gjykata e Apelit Vlore është audituar deri në 31.08.2013 nga NJ.A.B.

Në raportin e auditimit paraardhës, janë lënë për zbatim 23 rekomandime të cilat janë pranuar dhe për zbatimin e tyre është hartuar plan veprimi nr prot 390 date 25.11.2013

**RAPORT FINAL
GJYKATA E APELIT VLORE**

Nga auditimi i zbatimit rezultoi se jane e realizuar 21 rekomandime dhe nuk jane realizuar 2 rekomandime .

Rekomandimet e pazbatuara jane :

1.Sistemet organizative.

1.Te axhustohet rregullorja e brendshme e gjykates ne tere elementet e manxhimit drejtimit ekonomik, Sektoret e gjykates kancelari, sherbime nga titullari i instucionit duke perfshire dhe elemente e sigurise dhe te mjedisit te kontrollit ne gjykate.

2.Ne sistemin e pagave

1.Ne lidhje me pagesen znj. Sashenka Jonuzi ne shumen 2057904 leke , shkaktuar buxhetit te shtetit dem ekonomik te aketueshem ne arken e shtetit, ne kundershim me ligjin organik te pushtetit gjyqesor per shkak te vendimit nr. 248 date 04.11.2012 te Keshillit te Larte te Drejtesise te gjendet forma ligjore e arketimit te kesaj shume ne buxhet duke njoftuar per kete dhe institucion mbi gjetjen nga auditi.

VI.OBSERVACIONE

Nga ana e gjykates nuk ka observacion

VII. KONKLUZIONE REKOMANDIME DHE PLAN VEPRIMI I GJYKATËS

Duke vlerësuar frymën e bashkëpunimit dhe të mirëkuptimit të gjykatës tuaj, NJAB- arrin në konkluzion që:

Gjykata e Apelit Vlorë , paraqet një performancë të mjaftueshme në menaxhimin e fondeve buxhetore, burimeve njerëzore dhe shërbimeve gjyqësore.

Në përfundim të procesit të vlerësimeve të bëra, bazuar në nenin 21, pika 7 të ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" për arritjen e objektivave në vitin 2015; kërkojmë dhënien e rekomandimeve për ndreqjen e parregullsive, si dhe masat konkrete të cilat synojnë të ulin mundësinë e përsëritjes së këtyre rasteve në të ardhmen në këtë subjekt auditues sipas sistemeve vijon:

1.Sistemi organizativ.

1.Kryetari i gjykates në përputhje me kërkesat e ligjit Ligjit Nr. 10296, .datë 8.7.2010, "Për menaxhimin Financiarë dhe Kontrollin", mbi bazen e gjetjeve ne funksionimin e mjedisit te kontrollit, te marre masa per azhornimin e rregullores , me kerkesat e ligjit 10296, date 08.07.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin" me detyrimet e kreut II, neni 8 "Pergjegjshmera menaxheriale e titullarit", ku percaktohet se titullaret e njesive publike jane pergjegjes per "miratimin e nje strukture te pershtatshme organizative dhe vendosjen e linjave te raportimit, qe mundesojne kryerjen efektive te pergjegjesive te tyre" duke perfshire ne rregullore edhe pershkrimin e detyrave per punonjesin e IT.

I përket Kryetarit të Gjykatës, Kancelarit

Niveli i prioritetit. Gjate vitit

Reagimi i menaxhimi po per zbatim

**RAPORT FINAL
GJYKATA E APELIT VLORE**

2. Kryetari i gjykates në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 10290, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", mbi bazen e gjetjeve në funksionimin e mjedisit të kontrollit, krijimin grupit menaxhimit strategjik, të marre masa për hartimin e rregjistrave, për menaxhimin e rriskut në gjykate si pjesë e funksionimit dhe mirë administrimit të pasurisë publike dhe fondeve buxhetore

3. Nga ana e kryetarit të merren masa për hartimin e deklaratës për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në fund të vitit, në përputhje me ligj. Nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" të ndryshuar.

5. Në funksion të mjedisit të kontrollit të brendshëm në përputhje me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" të ndryshuar, sektoret e gjykates kancelari, shërbime gjyqësore dhe zyra e buxhetit të miratojnë planet e punës me prioritetë dhe të raportojnë të titullari në mënyrë periodike.

I përkasin Kryetarit të Gjykatës, Kancelarit

Niveli i prioritetit. Në vijimesi

Reagimi i menaxhimit po për zbatim

2. Sistemin e planifikimit dhe zbatimit të Buxhetit.

3. Sistemi Pagave dhe Pagesave.

1. Për llogaritjen e pagesave për shërbimet e eksperteve, përkthyesve, avokateve, psikologëve etj, në rastin kur për pagesën e tyre veprohet me vendim të ndërmjetëm gjyqësor, përpara shpalljes së vendimit të ndërmjetëm duhet të dorëzohet dokumentacioni vertetues, justifikues, etj, i punës së kryer nga ta, të llogariten shpenzimet nga dega e buxhetit dhe kancelaria të nënshkruhen prej tyre dhe të paraqiten pranë gjyqtarit nëpërmjet sekretarës së seancës. Ndërsa në rast se përdoret vertetimi ky duhet të konfirmohet nga kancelari duke i bashkëlidhur dokumentacionin vertetues në rastet kur ka shpenzime të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", pjesa VI, kreu I, nenet 105-109, të nxirret akti administrativ, të kryhet kontabilizimi dhe të bëhet ndalesa për pagesat e kryera me tepër për përkthyesin në vlerën 8669 lek.

I përket Kryetarit të Gjykatës, Kancelarit, KDBuxhetit

Niveli i prioritetit. Në vijimesi

Reagimi i menaxhimit po për zbatim

4. Për punonjësit që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës dhe përfitojnë dietë në përputhje me VKM 997 datë 10/12/2010 Kryetari i gjykates duhet të autorizojë dërgimin me shërbim të punonjësit ku të përcaktohet qëllimi dhe koha e zgjatjes së shërbimit.

I përket Kryetarit të Gjykatës, KDBuxhetit

Niveli i prioritetit. Ne vijimesi

Reagimi i menaxhimi po per zbatim

4.Sistemi i prokurimit , blerjeve të vogla dhe zbatim kontratash

1. Njesia e Prokurimit perpara hartimit te Urdherit te Prokurimit duhet te kryeje llogaritjen e Vleres Limit te Kontrates(fondit limit) dhe ta administroje ate në dosjen e prokurimit në përputhje me VKM nr.914 date 29.12.2014."Rregullat e Prokurimit Publik" neni 9, neni 57,59.
2. Kryetari Gjykates ne cilesine e autoritetit kontraktor te marri masa per trajnimin e punonjesve te angazhuar ne prokurimet publike ne zbatim te VKM nr.914 date 29.12.2014."Rregullat e Prokurimit Publik" neni 83 ,pika 2 .
3. Kryetari Gjykatës në cilesine e autoritetit kontraktor të marrë masa për mbikqyrjen e cilësise së realizimit të kontratave veçanërisht të ruajtjes dhe sigurisë fizikese godinës gjykatës në përputhje me VKM nr.914 date 29.12.2014."Rregullat e Prokurimit Publik" neni 77.

I përkasin Kryetarit

Niveli i prioritetit: Menjehere dhe në vijimësi

Reagimi i menaxhimit: Dakort me zbatimin

5.Sistemi raportimit publik

1. Per enegjine elektrike konsumi i se ciles kryhet nga nje mates te lidhet akt marrveshje me Prokurorine e Apelit Vlore ku te percaktohet masa e pageses ne perqindje te secilit institucion dhe te administrohet ne arkiven e gjykates.
2. Nga ana e krytarit te merren masa per nderprejen e faturimit afrofe te konsumit te ujit duke i kerkuart zyrtarisht ndermarrjes se ujsjellesit instalimin e matesit te konsumit te ujit.

I përkasin Kryetarit të Gjykatës ,Kanelarit , KDBuxhetit

Niveli i prioritetit. Menjehere

Reagimi i menaxhimi po per zbatim

3. Nga dega e buxhetit te kryhet rakordimi vjetor me operatoret e konomike me akt rakordimi me shkrim ,te neneshkruar nga palet dhe te administrohen ne dokumentacionik ekonomiko financiar te gjykates.
4. Nga dega e buxhetit te merren masa për mbajtjen e ditarit te arkës , librit te arkes ,librit te pullave ne perputhje me ligjin "Per kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" , kryerjen e veprimeve te arkes ne perputhje me udhezimin nr 30 datë 27/02/2011 "Për menaxhimin e Aktiveve në NJSP" si dhe depozitimimin ne llogarite e thesarit te vlerave monetare të arkëtuara menjehere pas pranimit te tyre.

I përkasin : Degës Buxhetit

**RAPORT FINAL
GJYKATA E APELIT VLORE**

Niveli i prioritetit: Ne fund cdo viti

Reagimi i menaxhimit: Dakort me zbatimin

5. Vlera prej 95 000 lek gjendje ne arke qysh nga viti 2013 te depozitohet menjehere ne llogarite e thesarit si e ardhur per llogari te buxhetit te shtetit.
6. Nga ana kryetarit gjykates te merren masa per ndalimin e arketimeve ne arken e gjykates te shumave per llogari te eksperteve ne çeshtje civile por depozitimi i tyre ne banke ne llogarite e eksperteve.

I përkasin Kryetarit të Gjykatës, KDBuxhetit

Niveli i prioritetit. Menjehere

Reagimi i menaxhimi po per zbatim

6.Sistemi IT


Këto rekomandime pasi të vlerësohen nga ju, do të shërbejnë si bazë për zbatimin e plan veprimit dhe reagimit, me qëllim përmirësimin e punës, duke nxjerrë aktet përkatës dhe personat përgjegjës që do t'i zbatojnë ato gjatë vitit 2016 e në vazhdim.

Raporti Final hartohet në dy kopje


GRUPI I PUNËS

Audit Përgjegjës Grupi

Aristotel Telhaj


Audit

Trëndafille Ajazi





Vlorë më 26.10.2016

INFORMACION

1-Në Gjykatën e Apelit Vlorë është kryer procedura kërkes me propozim për Ruajtjen e Objektivit “Gjykata dhe Prokuroria Apelit Vlorë” me roje të sigurisë private .

2-Është lidhur kontrata me firmën fituese”Velaj “shpk, në datën 01.04.2016 deri më 31.12.2016 ,vlera e kontratës është

1.787.999.23(njëmilion e shtatëqind e tetëdhjet e shtatë mijë e nëntëqind e nëntëdhjet e nëntë pikë njëzet e tre) lekë.

3- Shërbimi që kryen është ruajtja e sigurisë së Gjykatës dhe Prokurorisë së Apelit Vlorë me roje të sigurisë private.



K/D/Buxhetit
Albana Balla